




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Ref: 1509/1095/BA/dk

## VENDIMI I BORDIT PËR ANKESA

në çështjen e Ankesës nga

EGC

(“Palë Ankuese”)

I përfaqësuar nga:  
Z. Leonard Hoxhaj

kundër vendimit të  
Komisionit të Pavarur për Media

(“KPM”)

në Ankesën 2015/39  
(Vendimit të KPM-së të datës 28 prill 2015)

### Faktet

1. Me vendimin e tij 2015/39 të datës 28 prill 2015 (Ref: 1504/359/LEG/hzg, Komisioni i KPM-së shqiptoj gjobën prej 3,000.00 (tremijë) euro kundër Palës Ankuese për shkelje të nenit 2 paragrafi 1.3 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës.
2. Bordi për Ankesa, vlerëson se Komisioni në mënyrë të rregullt ka analizuar provat materiale të parashtruara nga operatori kabllor IPKO dhe Elektron dhe ka gjetur se Pala Ankuese ka bartur kanalën Top Channel pa të drejtë për transmetim.
3. Bordi për Ankesa bazuar në ankesat e pranuar, me datën 18 mars 2015 përmes një kërkesë dërguar Palës Ankuese ku i është kërkuar, që në afat prej pesë (5) ditësh ta sjellë marrëveshjen valide me të cilën dëshmon se ka të drejtën e bartjes së kanalit Top Channel.
4. Bordi për Ankesa gjen se KPM me datën 23 mars 2015, ka pranuar një përgjigje nga Pala Ankuese, për të cilën ka informuar që nuk posedon të drejtë të autorit për bartjen e kanalit Top Channel dhe se nuk është duke bërë bartjen e këtij kanali.

5. Bordi për Ankesa gjithashtu gjen se Palës ankuese me datën 24 mars 2015, i është dërguar Njoftim për Shkelje përmes të cilit i është kërkuar të veprojë në pajtueshmëri me Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës, në të kundërtën do të ndërmarrën masa ligjore ndaj Palës Ankuese nga ana e KPM-së.
6. Bordi për Ankesa gjen se edhe pas dërgimit të Njoftimit për Shkelje, me datën 27 mars 2015, KPM ka pranuar edhe një përgjigje përmes së cilës Pala Ankuese pretendon se ankesat janë bërë duke falsifikuar materialet, pasi që ata nuk e bartin kanalën Top Channel. Pala Ankuese nuk e mohon faktin që kjo mund të ketë ndodhur për shkak të problemeve teknike.
7. Bordi për Ankesa bazuar në raportin e monitorimit të datës 23 shkurt 2015, ka gjetur se edhe përkundër kërkesë se datës 18 mars 2015, dhe Njoftimit për Shkelje të datës 24 mars 2015, Pala Ankuese ka vazhduar të jetë në kundërshtim me nenin 2 paragrafi 1.3 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës.

#### Vendimi

8. Bordi për Ankesa, pas shqyrtimit të argumenteve të paraqitura nga KPM dhe Pala Ankuese konstatoi se, Vendimi i Komisionit të KPM-së është marr në pajtim me Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës, Ligjin e KPM-së dhe gjendjen faktike të konstatuar pas vlerësimit të provave materiale.
9. Bordi për Ankesa duke u bazuar në faktin se KPM ka bërë vlerësim të drejtë të ligjit material, procedural dhe vlerësim të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në pajtim me nenin 36, paragrafi 3, të Ligjit të KPM-së vërteton Vendimin e KPM-së Nr. 2015/39, si të drejtë dhe të ligjshëm.

#### Arsyetimi

10. Bordi për Ankesa në seancën e mbajtur me datë 27 gusht 2015, ka bërë shqyrtimin dhe analizimin e të gjitha fakteve dhe provave relevante përfshirë këtu të gjitha raportet e monitorimit, provat e deponuara nga palet e dëmtuara dhe Njoftimin për Shkelje i cili i është dërguar Palës Ankuese.
11. Bordi për Ankesa gjatë analizimit të raportit të monitorimit dhe provave materiale të palës së dëmtuar (IPKO), të cilat prova edhe pas vlerësimit nga ana e Bordit për Ankesa kanë rezultuar të jenë të vërteta, konstaton se Pala Ankuese ka transmetuar kanalën Top Channel, pa të drejtë autoriale duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 2 paragrafi 1.3, të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës i cili përcakton se:
 


*“I Licencuari nuk do të ritransmetoj asnjë program pa marrëveshje valide mbi të drejtën e autoriale. Bartja e kanaleve të programeve pa të drejtë autoriale përbën shkelje të rëndë të Kushteve dhe Termeve të Licencës dhe shkelje të tilla rezultojnë më revokim të licencës”.*
12. Bordi për Ankesë konstaton se Pala Ankuese përmes ankesës se saj nuk arrin të dëshmojë faktin se ka vepruar në pajtim me të drejtën e transmetimit, arsyetimi i


palës ankuese konsiston në faktin se shkelja mund të këtë ndodh për shkak të problemeve teknike, duke mos e përjashtuar shkeljen e te drejtës se autorit.

13. Bordi për Ankesa duke u bazuar në provat materiale të dorëzuara nga ana e Palës Ankuese dhe nga KPM-ja gjen se Pala Ankuese ka bartur kanalën Top Channel pa marrëveshje mbi të drejtën e autorit, veprim ky i cili bie në kundërshtim me nenin 2 paragrafi 1.3 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës.
14. Bordi për Ankesa konstaton se Pala Ankuese është e obliguar të respektoj të gjitha detyrimet të cilat rrjedhin nga licenca, duke filluar prej respektimit të Ligjit të KPM-së dhe të gjitha aktet nënligjore.

#### Rishikim procedural

15. Vendimet e bordit janë përfundimtare në pajtim me nenin 44.2 të Ligjit për KPM-në.
16. Palët në vendim mund të dorëzojnë kërkesën për rishikim procedural në Gjykatë Supreme të Kosovës në pajtim me ligjin e aplikueshëm.
17. Inicimi i rishikimit procedural nuk ndalon zbatimin e vendimeve të Komisionit të KPM-së ashtu siç mbështeten apo modifikohen nga Bordi.

  
\_\_\_\_\_  
Dauf KRASNIQI  
Kryetar, Bordi për Ankesa



27.08.2015  
data

Lloji i dërgesës  
Vista postiljke 1095

Vlera e cekur - Shuma e dërguar  
Oznaçona vlerdosi - posilani iznos  
nën numër EGC - LEONARD HOXHAJ  
pod br.  
për RA. I SHKËT DASHIMI - KUMANOVA - VLLASHINË  
za

PRIZREN  
(Vendi)  
(Mesto)

Posthtë i nënshkuarri deklarôn që dërgesa e cekur (shuma e dërguar) është dorëzuar në rregull (paguar me datë) 15.09.2015  
Dole përplisani izjaviluje da je pomenuta postiljka (posilani iznos) predata uredno (placena dana)

Nënshkrimi i marrësit  
Potpis primaoca [Signature]

Vula e postës së vendit  
Peçat pošte 

Nënshkrimi i nënpunësit të postës së vendit  
Potpis radnika pošte [Signature]